



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS

OPINION MBI KANDIDATIN Znj. SONILA MUHAMETAJ (DOMI)

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53/2, 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në nenin 5 të ligjit nr.113/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST”, në datën 24.02.2020 me vendimin nr.74, ka hapur garën për të shprehur intresin për t’u komanduar si **Prokuror ndërlidhës pranë Eurojust** nga kandidaturat që vijnë nga radhët e prokurorëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre.

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 2 (dy) javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë kanë paraqitur kërkesë 2 (dy) prokurorë.

Në datë 11.03.2020 pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është protokolluar kërkesa e prokurores Sonila Muhametaj, e cila aktualisht ushtron funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallë së Parë Tiranë dhe ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në pozicionin e Prokurorit ndërlidhës pranë EUROJUST.

Në zbatim të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 54/4 Komisioni për Zhvillimin e Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të prokuroris ku kandidati ushtron funksionin.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur opinionin ligjor pasi ka verifikuar, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kriterëve ndaluese si dhe duke vlerësuar cënimin apo dëmtimin e funksionalitetit të prokurorisë ku ushtron detyrën prokurori që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e prokurorit, rezulton se:

Prokurorja Sonila Muhametaj ushtron funksionin e magjistratit që prej vitit 2006, ku është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë. Më pas ka punuar si Prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Pukë dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Nga dosja personale rezulton se ka një eksperiencë profesionale në punë për afro 14 (katërmëdhjetë) vjet si Magjistrat, duke përmbytur kushtet e vjetërsisë në punë. Znj. Muhametaj nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar, nuk është dhe as ka qenë më parë e komanduar dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Gjithashtu Znj. Muhametaj ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar me Vendim të formës së prerë.

Për sa i përket eksperiencave në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë ajo ka eksperiencë në hetimin e çështjeve të ndryshme në bashkëpunim me autoritete të huaja dhe ekstradimeve, ekzekutimit të letër porosive, njohjen e vendimeve penale të huaja, etj

Për sa i përket njohjes së Gjuhës Angleze, Znj. Muhametaj ka njohuri të Gjuhës Angleze (nuk specifikohet certifikata). Përveç sa më sipër Znj. Muhametaj ka marrë pjesë në shumë trajnime brenda dhe jashtë vendit.

➤ Në këto kushte për këtë prokuror nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesi të lartë) të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin, nga informacioni e mendimi i marrë nga Drejtuesi i Prokurorisë ku është e caktuar, rezulton se:

➤ Nga kthim-përgjigja me shkresën nr.3923/1, datë 22.07.2020 e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë shprehet se mbështet kandidimin e prokurores Sonila Muhametaj. Duke e vlerësuar kandidaturën e saj, në raport me interesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mbetet për tu vlerësuar nga ana e Këshillit për shkak të ngarkesës së punë.

Në këto kushte, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se komandimi i znj. Sonila Muhametaj (Domi) pranë EUROJUST nuk passjell cenim të interesave të larta të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe nuk cenohet funksionaliteti i saj.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

Vijimin e procedurave të komandimit për kandidatin prokuror Znj. Sonila Muhametaj (Domi).

KOMISIONI PËR ZHVILLIMIN E KARRIERËS

KRYETAR

SANDËR BECI

ANËTAR

BUJAR SHESHI

ANËTAR

VATË STAKA